

## Mësimi 1

### Si vështrohet një person nga të tjerët

Personi është shumë më tepër se sa mund të mendojë dikush

<b>Objektivi i mësimnxënies</b>	Nxënësit përballen me kompleksitetin e opinionëve dhe i bëjnë zgjedhjet e tyre.
<b>Detyrat e nxënësve</b>	Nxënësve u caktohen role specifike dhe ata krijojnë opinionet e tyre. Ata mësohen si të ndryshojnë perspektivën.
<b>Burimet</b>	Përshkrimi i roleve, prospektet 1.1 (grupet 1-3), fletë të mëdha të letrës, shënues (markera).
<b>Metoda</b>	Punë në grupe.

## Mësimi

Nxënësit formojnë tri grupe dhe marrin prospektet për nxënës 1.1 (në tri versione të ndryshme për grupet e ndryshme), një fletë të madhe të letrës dhe shënues (marker). (Në klasat e mëdha mund të formohen më shumë grupe dhe mësimdhënësi atëherë siguron më shumë skena për lojë ose detyra e njëjtë u jepet grupeve të ndryshme. Kjo e fundit mund të jetë një skenar interesant, sepse do të tregojë se sa mund të jenë të ndryshme përshkrimet dhe të kuptuarit.) Pastaj mësimdhënësi e tregon tregimin e djaloshit që e ka ndërruar shtëpinë dhe është duke eksploruar mjedisin e tij të ri. Ai i tregon klasës për ditarin e djaloshit por atë nuk ia lexon klasës me zë, meqë çdo grup ka marrë vetëm një pjesë të tekstit.

### Informacionet e prapaskenës vetëm për mësimdhënësit

Teksti i tërë është si vijon:

*“Kjo është dita ime e parë në klasën e re. Familja ime ka ardhur këtu nga një rajon tjetër dhe unë akoma ndjehem si i huaj. I dashuri ditar, shumë gjëra më kanë ndodhur gjatë ditëve të fundit. Do të tregoj disa prej tyre.*

*Ne tani jetojmë në një banesë afër lumit. Njëri prej djemve të klasës jeton disa banesa larg meje. Ai erdhi tek unë që ditën e tretë të më ftoj të shkoj në peshkim me të. Unë i thash jo sepse grepi im është akoma i paketuar në njëren prej paketave.*

*Para objektit të shkollës sonë ndodhet një fushë e madhe futboll. Unë u gëzova për këtë sepse më pëlqen të luaj futboll. Pra unë e solla topin me vete dhe doja të filloj stërvitjen. Posa kisha filluar të bëj një ose dy goditje në gol kur më ndali kujdestari i shkollës. Ai ishte i zemëruar dhe më pyeti nëse unë dija të lexoj apo jo. Unë nuk e kisha parë shenjën ku thuhej se fusha ishte e mbyllur pas shiut. U trondita aq shumë sa që shkova në shtëpi pa e thënë asnjë fjalë.*

*Një njeri i moshuar jeton i vetëm në banesën sipër nesh. Kur unë erdha në shtëpi dje, atë e takova në derën kryesore me gjësendet që i kishte blerë. Ai kishte një qese me ushqim dhe mbushej frymë thellë. Mua më erdhi keq për të, dhe e pyeta nëse mund t’i ndihmoja, dhe ia barta qesen deri tek dera e tij.”*

Tri versionet e prospektëve për grupet përmbajnë pjesë të ndryshme të ditarit. Perceptimi i grupeve do të varet nga informacionet që ata i kanë marrë. Prandaj, çdo grup sheh vetëm një pjesë të identitetit të djaloshit dhe këtë opinion e reflekton në luajtjen e rolit. Ashtu siç kërkohet në detyra, grupet së pari paraqesin grupet e tyre të mbiemrave. Një anëtar i çdo grupi i mbledh rezultatet nga diskutimi në grup në një fletë të madhe të letrës për t’i prezentuar në mësimin e ardhshëm.

Tani çdo grup vendos për një rol të shkurtër të lojës që paraqet interpretimin e tyre. Luajtja e këtyre roleve së pari duhet të shpjegohet dhe të diskutohet në klasë dhe pastaj të përsëriten. Kjo mund të bëhet në kënde të ndryshme të klasës, ose ndoshta në sallat e mbledhjeve në objektin e shkollës, në objekte të jashtme ose, nëse këtë e lejon koha, në oborrin e shkollës. Edhe nëse luajtja e këtyre roleve merr pak kohë në fillim, mundi do t’ia vlejë. Për shumë nxënës, ajo çka është e vështirë për t’u shprehur me fjalë tani mund të thuhet thjeshtë dhe qartë.

Objekti i nxënësve në këtë mësim është që të shënojnë listën e mbiemrave në posterët dhe të përsërisin skenën.

Në fund të mësimit mësimdhënësi i mbledh posterët (ai i rishpërndan ato në fillim të mësimit të ardhshëm) dhe bën një rishqyrtim të shkurtër. Ai reagon pozitivisht dhe shikon temën për mësimin e ardhshëm.